

**L I G J**  
**Nr.9164, datë 18.12.2003**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9136, DATË 11.9.2003 "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2 e nenit 9 shfuqizohet.

Neni 2

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10

**Detyrimi për të deklaruar**

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute duhet të dorëzojë në organet tatimore një deklaratë për çdo periudhë.

2. Deklarata duhet të përmbajë shumën e kontributeve për t'u paguar, shumën dhe tipin e përfitimeve të paguara dhe vlerën e kontributeve të paguara.

3. Personat që janë të detyruar të paguajnë kontribute dorëzojnë në organin tatimor deklaratën përkatëse, ku shënohet për çdo person emri, numri i sigurimeve shoqërore, shuma e kontributeve për t'u paguar dhe shuma e përfitimeve.

4. Formularët e deklarimit, të përmendur në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji."

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

**Afatet e deklarimit dhe të pagesës**

1. Deklarata e përmendur në pikën 1 të nenit 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

a) nga punëdhënësi, çdo muaj, jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës;

b) nga personi i vetëpunësuar, jo më vonë se data 25 e muajit të fundit të çdo tremujori të vitit kalendarik, siç përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punës e Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji.

2. Deklarata e përmendur në pikën 3 të nenit 10 bëhet në afatin e përcaktuar në udhëzimin e

përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji.".

Neni 4

Fjalja e fundit e pikës 2 të nenit 13 shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4081, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**